



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 319

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTit
VETËDEKLARUES Z. ARTUR XHEKE BUSHI, KANDIDAT PËR KRYETAR BASHKIE, I PROPOZUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR BASHKINË KRUIË**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z. Artur Xheke Bushi, kandidat për kryetar bashkie i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" për Bashkinë Krujë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

Data 12.4.2023 Nr: 319
Ora:12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të subjektit vetëdeklarues z.Artur Xheke Bushi, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste", për Bashkinë Krujë".

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte, ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtar në këshillin bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Artur Xheke Bushi, është regjistruar si kandidat për kryetar bashkie, propozuar nga "Partia Socialiste e Shqipërisë", për Bashkinë Krujë.

Për këtë kandidat, në datën 3.4.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili, është regjistruar me nr. unik DR-PS-21237. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, DPGJ informon se kandidati në fjalë, nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artur Xheke Bushi, rezulton:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij;
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 3 "A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO". Në vitin 1996, është verifikuar nga Prokuroria Italiane, por është liruar menjëherë nga Gjykata Italiane. Në vitin 2010, deri në vitin 2011, është hetuar nga Prokuroria Italiane, për "Trafik narkotikësh", por hetimi është pushuar dhe dosja është arkivuar.
- Pyetjes "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar, apo arrestuar, nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO". Në vitin 1996 është hetuar nga Prokuroria Italiane por është liruar menjëherë nga Gjykata Italiane dhe në vitin 2010, deri në vitin 2011, është hetuar nga Prokuroria Italiane për "Trafik narkotikësh", por hetimi është pushuar dhe dosja është arkivuar.
- Pyetjes "A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO". Është kërkuar masë shtrënguese "arrest me burg", por është revokuar nga Gjykata, në shtetin Italian.
- Pyetjes "A keni jetuar ndonjë herë jashtë territorit të Rpublikës së Shqipërisë për më shumë se

1 muaj?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”. Ka jetuar në shtetin Italian nga viti 1994 deri në vitin 2010, për arsye emigrimi.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve, si më sipër, në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja.

Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime. Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Artur Xheke Bushi, kandidat për kryetar bashkie, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për Bashkinë Krujë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI